



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 2/2025 regjistër (JD)
Datë 02.06.2025

Nr. 3 i vendimit
Datë 02.10.2025

VENDIM

PËR MOSKALIMIN E ÇËSHTJES PËR SHQYRTIM NË SEANCË PLENARE

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, i përbërë nga gjyqtarët:

Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, më datë 02.10.2025, ora 13:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2, datë 02.06.2025, që i përket:

KËRKUES: Kledian Llaho, prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.

**SUBJEKT I
INTERESUAR:** Këshilli i Lartë i Prokurorisë
Inspektorati i Lartë i Drejtësisë.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin i vendimit nr. 65, datë 10.04.2025 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me të cilin është vendosur: caktimi i masës disiplinore “Ulje të përkohshme të pagës” në masën 20 për qind për një periudhë 3 mujore, si dhe masën disiplinore plotësuese “Largimi nga detyra e kryetarit”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 108 dhe 114 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për shkeljet disiplinore të parashikuara përkatësisht nga neni 102 pika 2, shkronja “dh”, të ligjit nr. 96/2016.
2. Marrjen e masës me karakter urgjent duke u urdhëruar nga Kolegji pezullimi i efekteve të aktit administrativ individual të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, vendimi nr. 65, datë 10.04.2025 deri në përfundimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika 3, neni 131, shkronja “f” neni 134, pika 1, shkronja “i”, neni 140, pika 2, shkronja “a”, neni 179, pika 7; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; neni 5, pika 3, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Nenet 27, 49, 71, pika 3, 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 101, 102, 108, 112 dhe 147 i ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar; neni 192 i ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; nenet 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak të kërkesës, shqyrtoi në dhomë këshillimi kërkesën e kërkuarit dhe aktet bashkëlidhur saj dhe pasi dëgjoi gjyqtaren relatores Mimoza Tasi, e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Kërkuar/ankuesi Kledian Llaho (në vijim “ankuesi” dhe/ose “magjistrati”), ka ushtruar detyrën e Drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë.
2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), ka administruar shkresën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “ILD”), nr. {***} prot., datë 30.12.2024, *“Për fillimin e procedimit disiplinor”* ndaj prokurorit Kledian Llaho, duke i propozuar Këshillit, *“Uljen e përkohshme të pagës në masën 40 % për një periudhë 1-vjeçare”* si dhe masën disiplinore plotësuese *“Largimi nga detyra e kryetarit”*. Hetimi disiplinor ka nisur bazuar në disa ankesa të paraqitura nga prokurorja B. S. e cila ka paraqitur pretendime për shkelje të dispozitave ligjore nga ana e drejtuesit të Prokurorisë z. Kledian Llaho, që kanë të bëjnë me ndërhyrjet në veprimet hetimore, me shpërndarjen e çështjeve, si dhe me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes, referuar disa materialeve kallëzuese.
3. KLP-ja, me vendimin nr. 65, datë 10.04.2025 “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistratit Kledian Llaho”, ka vendosur: - *Pranimin pjesërisht të kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ...2. Caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës në masën 20 % për një periudhë 3(tre) mujore për magjistratin Kledian Llaho; 3. Dhënien e masës disiplinore “Largimi nga detyra e kryetarit”*. - *Kundër vendimit lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, - Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë....*
4. Kërkuar/ankuesi Kledian Llaho, pasi është njohur me vendimin e KLP-së nr. 65, datë 10.04.2025, ka paraqitur kërkesë në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), në datën 02.06.2025, duke kërkuar *[...shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën dhe me ligjin të vendimit nr. 65, datë 10.04.2025 të KLP-së...]*. Kjo çështje është regjistruar në regjistrin e çështjeve të Juridiksionit Disiplinor me (JD) nr. 2/2025, datë 02.06.2025.

I. VLERËSIMI I KOLEGJIT PËR SHQYRTIMIN PARAPRAK

5. Në drejtim të shqyrtimit paraprak, neni 27 i të njëjtit ligj parashikon elementet që duhen verifikuar e që lidhen me aspektet formale të kërkesës, ndërsa neni 31/a, përcakton elementët të cilët diktojnë moskalimin e çështjes në seancë plenare. Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, (në vijim “Kolegji Paraprak”), pas shqyrtimit të kërkesës/ankimit, vlerësoi të ndalej në trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me: i) *juridiksionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e kësaj çështjeje*; dhe ii) *verifikimin e plotësimit të kushteve për gjykimin e saj në seancë plenare*, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 8577/2000”).
6. Lidhur me juridiksionin për gjykimin e kësaj çështjeje, Kolegji Paraprak identifikoi bazën ligjore të zbatueshme për shqyrtimin e çështjes (JD) nr. 2/2025, në kuadër të Juridiksionit Disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për të cilën konstatoi se:

6.1. Kërkimet e paraqitura nga ankuesi janë kompetencë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nën dritën e pikës 4 të nenit 140 të Kushtetutës, e cila përcakton të drejtën e ankimit të gjyqtarëve kundër vendimit të shkarkimit në Gjykatën Kushtetuese. Lexuar në harmoni me parashikimet e nenit 179, pika 7¹ e Kushtetutës, gjatë mandatit 9-vjeçar të veprimtarisë së Kolegjit, këto ankime bëjnë pjesë në kompetencën e tij, nën juridiksionin disiplinor. Sipas nenit 5, pika 3, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 baza ligjore mbi të cilën procedon Kolegji gjatë ushtrimit të funksionit të tij në juridiksionin disiplinor është Kushtetuta, ligji nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacioni që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

6.2. Çështja e legjitimitetit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, germa “f” dhe 134, pika 1, germa “i” dhe pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, i ndryshuar, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

6.3. Sipas pikës 1 të nenit 192 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore *mbi prokurorët*, ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Në vijim të dispozitës së sipërcituar të Kushtetutës, funksionin e shqyrtimit të këtyre ankimeve, gjatë mandatit të tij 9 vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm i Apelimit. Po ashtu, vendimi i marrë nga KLP-ja për ankuesin është një ndër masat disiplinore të përcaktuara në nenin 105 pika 1² të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

¹ Kjo dispozitë parashikon se: “Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.”

² “1. Këshillat mund të vendosin një ose më shumë nga këto masa disiplinore: a) vërejtje konfidenciale; b) vërejtje publike; c) ulje e përkohshme e pagës: i) deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit; ii) në rastin e

6.4. Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se Kolegji i Posaçëm i Apelit ka juridiksion *ratione materiae* për të shqyrtuar ankimet ndaj vendimeve për dhënien e masave disiplinore ndaj magjistratëve.

7. Në këndvështrim të verifikimit të plotësisimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 8577/2000, lidhur me kalimin për gjykim të ankimit në seancë plenare, Kolegji Paraprak konstaton se:

7.1. Ligji nr. 8577/2000, në kreun V rregullon çështjet lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin paraprak të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese. Ky kre, në drejtim të shqyrtimit paraprak, në nenin 27 të tij parashikon elementet që duhen verifikuar e që lidhen me aspektet formale të kërkesës dhe në nenin 31/a të këtij ligji, elementet, ekzistenca e të cilave çon Kolegjin Paraprak drejt vendimmarrjes për moskalimin e çështjes për gjykim në seancë plenare.

7.2. Në lidhje me verifikimin e të dhënave referuar kërkesave të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, ekzistenca e të cilave bën që kërkesa të mos kalojë për shqyrtim në seancë plenare, konstatohet sa vijon.

7.3. Kërkuesi/ankuesi legjitimohet *ratione personae*, sipas pikave 2/b e 2/c të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, objekt ankimi është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor që ka pasoja direkte mbi ankuesin dhe është paraqitur nga vetë magjistrati Kledian Llaho.

7.4. Kërkuesi/ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi është protokolluar në Kolegji në datën 02.06.2025, vendimi i KLP-së, mban datën 10.04.2025 ndërsa afati sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000, është 4 muaj³.

7.5. Lidhur me kërkesën e pikës 2, germa “d”, të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, e cila kërkon të verifikohet nëse kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive para se t’i drejtohet Kolegjit, siç është analizuar më sipër, vendimet e KLP-së për dhënien e masës disiplinore janë të ankueshëm vetëm pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për pasojë nuk ka pritshmëri për ezaurim të ndonjë mjeti tjetër ankimi.

7.6. Në drejtim të verifikimit të kushteve të parashikuara në nenin 31/a të ligjit nr. 8577/2000, Kolegji Paraprak vlerëson të evidentojë parashikimin e pikës 2, germa “dh” të tij, sipas të cilës, moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur [...] *rivendosja në vend e së drejtës së shkelur nuk është më e mundur*.

7.7. Për sa më lart, Kolegji Paraprak vlerëson se për shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesit/ankuesit duhet marrë në konsideratë fakti se: gjatë përgatitjes për shqyrtim të kësaj çështjeje, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit është gjykuar çështja (JR) nr. 11/2023, datë 10.03.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur

magjistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës. ç) ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në gjykatën e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër; d) pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitim të pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave; dh) shkarkim nga detyra.

³ Nga aktet konstatohet se KLP me datë 23.05.2025 nëpërmjet vendimit nr.105, ka miratuar ndryshimin e gabimit material në vendimin e KLP-së nr.65, datë 10.04.2025, në të dyja rastet ankimi është paraqitur në Kolegji brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar ligji.

të Kualifikimit, nr. 607, datë 22.12.2022, që lidhet me rivlerësimin kalimtar të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, Kolegji, me vendimin nr. 65, datë 01.08.2025 vendosi “Ndryshimin e vendimit nr. 607, datë 22.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Kledian Llaho. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm. Si efekt i këtij vendimi magjistrati Kledian Llaho nuk e ushtron më detyrën e prokurorit prej datës 01.08.2025, bazuar në pikën 3 të nenit 66 të ligjit nr.84/2016⁴, si dhe ka humbur statusin e magjistratit.

7.8. Kolegji Paraprak çmon se masat disiplinore kanë si qëllim korrigjimin ose ndëshkimin e magjistratit për sjelljen e tij të papërshtatshme në ushtrimin e funksioneve të tij, duke garantuar ruajtjen e integritetit dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Për rrjedhojë, masat disiplinore “*Ulje e përkohshme e pagës në masën 20 % për një periudhë 3(tre) dhe “Largimi nga detyra e kryetarit”*” të dhëna nga KLP-ja, në kushtet kur magjistrati Llaho nuk e ushtron më detyrën e prokurorit, janë shuar, duke e humbur qëllimin e tyre dhe efektin juridik. Për pasojë edhe pretendimi i kërkuarit lidhur me efektet financiare që ka sjellë kjo masë disiplinore, në rrethanat e reja të krijuara nuk mund të jetë më objekt i shqyrtimit kushtetues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

7.9. Për sa më lart, Kolegji Paraprak vlerëson se, pretendimet⁵ e kërkuarit/ankuesit për paligjshmërinë e vendimmarrjes së KLP-së si dhe ndikimin e saj në situatën financiare të tij, ndodhur para faktit që magjistrati Kledian Llaho ka humbur statusin e magjistratit, aktualisht, kanë mbetur pa objekt. Nga shqyrtimi i kësaj çështjeje në Kolegj nuk do të mund të rivendosej në vend e drejta që pretendohet nga ankuesi se është shkelur. Në këto rrethana rezulton e provuar situata e parashikuar nga neni 31/a, pika 2, “dh” e ligjit nr. 8755/2000.

7.10. Analizën e mësipërme Kolegji Paraprak e shikon të lidhur edhe me kriteret e përcaktuara në nenin 71/a, pika 1, germa “ç”, të ligjit nr. 8577/2000, që rregullon kushtet që duhet të përmbushë ankimi individual për t’u pranuar për shqyrtimin nga Gjykata Kushtetuese - në këtë rast, nga Kolegji. Për pasojë, rezulton se kërkesa/ankimi i paraqitur nga magjistrati Kledian Llaho nuk plotëson të gjitha kërkesat e ligjit, pasi, siç u analizua më sipër, në kushtet kur ai nuk ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, rivendosja e të drejtës së shkelur, të pretenduar nga ankuesi nuk është e mundur si pasojë e mbarimit të statusit të magjistratit.

7.11. Gjithashtu, për të njëjtat arsye Kolegji Paraprak çmon se nuk mund të shqyrtohet as kërkesa e ankuesit për “Marrjen e masës me karakter urgjent duke urdhëruar pezullimin e efekteve të vendimit nr. 65, datë 10.04.2025, deri në përfundimin e shqyrtimit të çështjes (JD) nr. 2/2025, datë 02.06.2025”.

8. Në përmbledhje të sa më sipër analizuar, bazuar në përcaktimet e nenit 31/a, pika 2 germa “dh” dhe nenit 71/a, pika 1, germa “ç” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, Kolegji Paraprak vlerëson se kërkesa/ankimi i regjistruar si çështja (JD) nr. 2, datë 02.06.2025 nuk plotëson kriteret për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

⁴ Vendimi i Kolegjit të Apelit, që vendos shkarkimin nga detyra, ka efekt të menjëhershëm ex lege.

⁵ Ankuesi pretendon se i është cenuar e drejta e pagës dhe e drejta e karrierës profesionale, lidhur me masën disiplinore “*Ulje e përkohshme e pagës në masën 20 % për një periudhë 3(tre) mujore*, kërkuar pretendon se ndonëse me karakter financiar, ajo ka ndikim në situatën e tij financiare. Ankuesi referon në nenin 43 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit pasja e një mase disiplinore e pengon atë drejtpërdrejt në zhvillimin e karrierës profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 31, nenin 31/a, pika 2, germa “dh”, si dhe nenin 71/a, pika 1, germa “c” dhe “ç” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

Tiranë, më datë 02.10.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi